

**Aneksi A****SHPALLJA E 2 VENDEVE TË LIRA TË PUNËS**

Tabela .1

Nr.	Pozicioni i punës	Struktura e interesuar/ Forca	Vendi ku ndodhet	Lloji i kontratës së punës	Procedura e përzgjedhjes së kandidatëve		Afati i aplikimit	
					Me dosje	Intervista	Fillimi	Mbarimi
1	Jurist	IGJIU, 6010	Tiranë	1-vit	Po	Po	26.08.2016	10.09.2016
2	Specialist / Jurist	AISM,	Tiranë	1-vit	Po	Po	26.08.2016	10.09.2016
3								
4								
5								
6								

Formulari nr. 1

<b>1.Pozicionet e punës: Jurist dhe Specialist/Jurist.</b>
<b>2. Kodi i pozicionit: .....</b>
<b>3. Reparti/Institucioni:</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>➤ Instituti i Gjeografise dhe Infrastruktures Ushtarake dhe</li> <li>➤ Agjencia e Inteligjencës dhe Sgurisë së Mbrojtjes.</li> </ul>
<b>4. Vendi: Tirane</b>
<b>5. Paga:VKM nr.589, date 17.07.2013 dhe VKM nr.545, datë 11.08.2011</b>
<b>6. Lloji i kontratës së punës: 1 - vjeçar</b>
<b>7. Data e fillimit të aplikimit: 26.08.2016</b>
<b>8. Data e mbylljes së aplikimit: 10.09.2016</b>
<b>9. Mënyra e aplikimit:</b>  Për të aplikuar kandidatët duhet të plotësojnë formularin e aplikimit, të cilin do ta gjejnë në faqen e internetit të Ministrisë së Mbrojtjes në adresën <a href="http://www.mod.gov.al">www. mod.gov.al</a> . Formulari pasi plotësohet, së bashku me dokumentacionin përkatës, të dorëzohet pranë:  Drejtorisë së Burimeve Njerëzore dhe Zhvillimit të Personelit  Ministria e Mbrojtjes  Rruga e Dibrës  Tiranë

## 10. Dokumentet e aplikimit:

Aplikantët duhet të paraqesin dokumentet e mëposhtme:

- kërkesën;
- formularin e aplikimit;
- fotokopje të kartës së identitetit;
- diplomën e shkollës së mesme/parauniversitare ose të lartë të noterizuar ose në origjinal;
- certifikatë ose dëshmi të gjuhëve të huaja
- raport mjekësor;
- fotografi me përmasa 4x6, 2 copë;
- dëshmi penaliteti;
- vërtetim nga gjykata;
- vërtetim nga prokuroria;
- librezë pune;
- jetëshkrimin (CV).
- formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në faqen e internetit të MM-së në adresën elektronike [www.mod.gov.al](http://www.mod.gov.al). (linku: *Baza ligjore/Akte ligjore/ Integriteti i personave që ushtrojnë funksione publike/formulari i vetdeklarimit*)

## 11. Kërkesat e përgjithshme të pozicionit të punës:

- a) të ketë shtetësinë shqiptare;
- b) të jetë jo më pak se 18 vjeç;
- c) të gëzojë zotësi të plotë për të vepruar;
- d) të plotësojë kërkesat për llojin dhe nivelin arsimor, si dhe të zotërojë aftësitë profesionale të domosdoshme, për vendin përkatës të punës, sipas kritereve të miratuara;
- ç) të mos jetë të dënuar me burg me vendim gjykate të formës së prerë për kryerje të një krimi;
- e) të mos jetë marrë masa disiplinore me largim nga puna, brenda 1 viti nga data e aplikimit.

## 12. Përshkrimi i punës:

- a) Detyrat kryesore:
  - Dhënia e mendimeve të kualifikuara ligjore për zbatimin në praktikë të akteve ligjore e nënligjore në fuqi.
  - Përfaqësimi i institucionit si dhe mbrojtja e projekt-akteve dhe dokumenteve shoqëruese, që prekin veprimtarinë e tij.
  - Dhënia e asistencës së nevojshme ligjore, si dhe kontrolli i bazueshmërisë ligjore të projekt-akteve që dërgohen për miratim.
- b) Përgjegjësitë:
  - Përgatitja e praktikave dhe ndjekja e plotë e proceseve deri në miratimin eventual dhe hyrjen në fuqi të projekt-akteve.
  - Ofrimi i bashkëpunimit, mbështetjes profesionale dhe këshillimit ligjor ndaj strukturave të brendshme në funksion të realizimit të detyrave në përputhje me pozicionin e punës.
  - Zbatimi i detyrave të tjera të ngarkuara në përputhje me pozicionin e punës.

**c) Procedura e përzgjedhjes së kandidatëve:**

Përzgjedhja e kandidatëve do të bëhet nga një komision vlerësimi i përbërë nga 3 (tre) veta.

Procedura e përzgjedhjes së kandidatëve do të bëhet si më poshtë:

- vlerësimi i dosjes, që konsiston në vlerësimin e arsimimit, të eksperiencës e të trajnimeve, të lidhura me fushën përkatëse;
- intervistën e strukturuar.

Totali i pikëve të vlerësimit të kandidatëve është 100 (njëqind), të cilat ndahen:

- a. 40 pikë, për vlerësimin e dokumenteve të kandidatëve;
- b. 60 pikë, për intervistën e strukturuar me gojë.

Përzgjedhja paraprake e kandidaturave do të realizohet nga Komisioni i Vlerësimit, mbi bazën e dokumentacionit të paraqitur nga kandidatët. Pas verifikimit të dokumentacionit të aplikantëve, nëse ai është i plotë dhe i saktë, si dhe plotësimi të kërkesave të pozicionit të punës Komisioni do të njoftohen për vazhdimin e mëtejshëm të konkurrimit kandidatët e kualifikuar.

**Vlerësimi i dokumenteve të kandidatëve me pikë do të jetë si më poshtë:**

- a. vlerësimin e jetëshkrimit (CV), 5 pikë;
- b. vlerësimin e kualifikimeve akademike, profesionale dhe teknike, 15 pikë;
- c. vlerësimin e trajnimeve, 5 pikë;
- d. vlerësimin e eksperiencave të ngjashme të punës, 15 pikë;

**Intervista** zhvillohet me kandidatët e kualifikuar në fazën e përzgjedhjes paraprake. Qëllimi i intervistës është të verifikojë aftësitë, motivacionin e çdo kandidati, si dhe përputhshmërinë e profilit profesional të kandidatit me pozicionin që do të mbulojë.

Intervista zhvillohet e strukturuar me qëllim që të sigurojë informacionin e saktë rreth profilit profesional të kandidatëve. Strukturohet në varësi të pozicionit që punonjësi do të mbulojë dhe eksperiencës që ka.

Gjatë intervistës kandidatit i drejtohen disa pyetje nga anëtarët e komisionit, përgjigjet e të cilave vlerësohen me pikë. Çdo pyetje ka një sasi të caktuar pikësh, të cilat vlerëson në varësi të përgjigjes. Në total intervista ka 60 pikë.

Në mbyllje të procesit të vlerësimit, tre kandidatët që kanë marrë më shumë pikë i paraqiten autoriteteve vendimarrëse për miratimin e kandidatit më të përshtatshëm për mbulimin e pozicionit të shpallur.

Me emërimin në pozicionin e punës do të lidhet kontrata individuale e punës.